



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 160, Datë 15.08.2024

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “HPG ENERGY” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.08.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1724/1 prot., datë 07.08.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “HPG ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “HPG ENERGY” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1724 prot., datë 02.08.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2MW dhe veprave ndihmëse, në Njësinë Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në pikën 1.1, gërmat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3 gërmat “a” dhe “c”; për pikën 2.1 gërmat “b”, “d”, “e” dhe “f”.
- Rezulton se shoqëria “HPG ENERGY” sh.p.k.:
 - Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) Kontratën me nr. 1961 Rep., nr. 1269 Kol., datë 06.04.2023, “Për Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale 3358, njësia administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier NGA shoqëria “HPG ENERGY” shpk”;

- Ka marrë ofertën për rimiratimin e pikës së lidhjes me rrjetin e shpërndarjes nga shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., nëpërmjet shkresës së kësaj të fundit nr. 2293/1 prot., datë 15.07.2024;
 - Është pajisur me Vendim për VNM Paraprake, lëshuar më datë 18.07.2024, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të ndërtuar impiantin fotovoltaik me fuqi 2 MW.
- Nga ky aplikim nevojitet të plotësohet informacioni/dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.3

- **gërma “b”:** Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacion vërtetues për disponimin e fondeve për realizimin e investimit sipas kontratës me MIE-n, duke iu referuar mënyrës së financimit të parashikuar në planin e saj të biznesit.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1

- **gërma “a”:** Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin teknik mbështetës në lidhje me jetëgjatësinë e pritshme të centralit fotovoltaik.
- **gërma “b”:** Shoqëria duhet të depozitojë informacion/dokumentacion në lidhje me zbatimin e afateve të kontratës së nënshkruar MIE-n.
- **gërma “c”:** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE rimiratimin final/marrëveshjen e nënshkruar me OSSH sh.a., për pikën e lidhjes.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HPG ENERGY” sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2MW dhe veprave ndihmëse, në Njësinë Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “HPG ENERGY” sh.p.k dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI